



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 94 prot.

Kamëz, më 18.7 .2021

V E N D I M

Nr. 78 .Datë 18/7 2021

MBI

MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.07.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt –Vendim Nr.67 Datë 13.07.2021** në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 8, datë 7.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Përpërdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ nr.37 datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime të aktit normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”,nenit 26, tëAktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimit nr. Nr.51 të Këshillit të Bashkisë datë 11.12.2019,i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.01.datë 19.01.2021 “Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019”, vendimit nr.160, datë 23.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Pë rmiratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2021” të ndryshuar, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesës së plotë të qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, për individët/familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, deri në pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Korrik 2021 me **shumë 1,638,000 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e**

Adresa: Bulevardi " NENE TEREZA " Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

tetë mijë) lekë me fonde 100% nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për periudhën Korrik-Dhjetor 2021 (viti buxhetor 2021) dhe në vazhdim do të trajtohen deri në rindërtimin/rikonstruksionin e plotë të banesave të tyre, sipas Aktit Normativ nr.37 datë 24.12.2020.

3. Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit do të koordinojë punën me Njësitë Administrative/Lagjet, Drejtorinë e Rindërtimit si edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për monitorimin e pagesës së qirasë për familjet përfituese, si edhe njofton strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë ose gjatë monitorimit konstatohet se nuk përmbushin më kushtet për të përfituar pagesën sipas legjislacionit në fuqi.
4. Efektet financiare, do të përballohen nga fondi i kushtëzuar akorduar për vitin 2021 nga Qeverisja Qendrore “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti”.
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti**

